



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E SHITES
MUNICIPALITY OF SHITE/ OPSTINA SHITLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE

ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA
INFORMISANJE

*Plani i Punës së Zyrës për Informim dhe
Komunikim me Publikun për vitin 2026*

Përmbledhja e aktiviteteve vjetore:

Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun, në kuadër të planit të punës për vitin 2026, ka paraparë realizimin e një sërë aktiviteteve informuese dhe publike. Këto përfshijnë publikimin në uebfaqen zyrtare të vendimeve të Kryetarit dhe të Kuvendit të Komunës, si dhe publikimin e planit të punës së Kryetarit të Komunës dhe të Kuvendit të Komunës për vitin 2026. Gjithashtu, është planifikuar publikimi i raporteve mujore dhe periodike financiare, si dhe i raportit vjetor financiar për periudhën janar-dhjetor 2025. Zyra do të publikojë njoftime dhe plane lidhur me konsultimet publike, takimet publike dhe dëgjimet buxhetore, si dhe njoftime-lajme për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, komiteteve jo obligative dhe Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Në kuadër të zyrës së informimit me publikun, do të publikohen lajme dhe njoftime për aktivitetet e Kryetarit të Komunës, drejtorive komunale dhe Kuvendit të Komunës. Po ashtu, pas miratimit nga MAPL, do të bëhet publikimi i rregulloreve, planeve dhe strategjive komunale. Zyra do të pranojë dhe shqyrtojë kërkesat për qasje në dokumente publike, si dhe do të publikojë raportin për Qasje në Dokumente Publike.

Në uebfaqe do të publikohen edhe Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2025, Projekt-Buxheti/KAB-i, buxheti final për vitin 2026-2029, si dhe Raporti i Performancës Komunale për vitin 2025.

Aktivitet sipas muajve të vitit 2026

Nr	Muaji	Nr i aktiviteteteve
1	Janar	16-aktivitete
2	Shkurt	14-aktivitete
3	Mars	11-aktivitete
4	Prill	10-aktivitete
5	Maj	11-aktivitete
6	Qershor	16-aktivitete
7	Korrik	15-aktivitete
8	Gusht	12-aktivitete
9	Shtator	11-aktivitete
10	Tetor	14-aktivitete
11	Nëntor	10-aktivitete
12	Dhjetor	13-aktivitete
		Totali i aktiviteteteve: 153

Vërejtje:

Vendimet e nënshkruara nga Kryetari i Komunës, dr. Qemajl Aliut, dërgohen në MAPL-ë për konfirmim ligjor dhe pas konfirmimit publikohen në uebfaqen zyrtare të komunës, në vegëzën: <https://shtime.rks-gov.net/vendimet/>. Dokumentet vlerësojmë se janë lehtë të qasshme për qytetarët, mediat, OJQ-të, dhe audiencat tjera relevante. Lajmet mund t'i gjeni të publikuara në këtë vegëz: <https://shtime.rks-gov.net/>

Vlora Hyseni

Zyrtare e Lartë për Informim dhe Komunikim me Publikun